

Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	FILMI DHE MEDIA FAKTIKE
Vlera e projektit:	Shuma e përgjithshme: € 138,598.66; Bashkëfinancimi (nëse ka) € 0
Kohëzgjatja:	Fillimi: 01/02/2018 Përfundimi: 30/11/2019
Organizata implementuese:	DokuFest
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	DOKUFEST Marin Barleti p.n. 20 000 Prizren info@dokufest.com 029 233 718
Grupet e synuara:	Nxënës të shkollave të Mesme Studente nga Universitetet
Partnerët:	Drejtorite Komunale për Arsimit në komunat përkatëse dhe shkollat e mesme të larta
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Komuna e Prizrenit, Prishtinës Suharekës, Dragashit, Malishevës, Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Kaçanikut, Vitisë, Mitrovicës dhe në fazën e tretë projekti do të shtrihet në tërë Kosovën.
Qëllimi i përgjithshëm:	Nxitja për krijimin e forumeve të pavarura për diskutim dhe shkëmbim të ideve, kështu që të provokohet vetëdije dhe të nxitet një debat publik më i fortë për rëndësinë e edukimit në përgjithësi dhe përfshirja sociale dhe arsimore e të gjitha komuniteteve përmes artit vizual, filmit dokumentar dhe animacioneve për të rinjtë.
Aktivitetet kryesore:	Organizimi i 30 shfaqjeve të filmave dhe diskutimeve nëpër shkolla të mesme në territorin e Kosovës. Organizimi dhe zhvillimi i moduleve/trajnimeve rreth hartimit të guidave të filmit me 22 mësimdhënës. Regjistrimi i vullnetarëve në platformën online dhe aftësimi i tyre, varësisht prej nevojave nëpërmjet departamenteve të ndryshme të DokuFest. Organizimi dhe zhvillimi i punëtorive teorike dhe praktike “Filmi dhe Media Faktike”. Prodhimi i së paku 4 filmave dhe organizimi i premierës në DokuFest. Mbajtja e Panel Diskutimit me temë për radikalizmin në Kosovë. Distribucioni i 4 filmave të prodhuar nëpër festivalet rajonale dhe ndërkombëtare.
Rezultatet e pritura:	Së paku 1000 të rinj synohet të marrin pjesë drejtpërdrejtë në diskutime për mediat faktike kundrejt propagandës përmes filmit dhe përgjatë punëtorive të fuqizohen në çështjet e radikalizimit, paragjyqimit, mostolerancës etnike si aktivitete të rëndësishme për të stimuluar dialogun dhe qytetarinë aktive. Së paku 300 vullnetarë të kualifikuar dhe të përfshirë në trajnime të punës në 2 edicionet e DokuFest (2018 dhe 2019) Së paku 30 pjesëmarrës vullnetarë do të mësojnë përdorimin dhe prodhimin e tregimeve vizuale të bazuara në interes shoqëror për shpërndarje në TV dhe internet. Prodhimi i së paku 4 filmave kualitativ dokumentarë në temat lidhur me të rinjtë dhe radikalizëm. Mbi 50,000 anëtarë të audiencës, shumica e tyre të rinj, do t'i shohin veprat e mbledhura të të rinjve përmes internetit, kinemasë udhëuese, TV dhe shfaqje të festivalit.

Përkrahur nga:



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG